



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORTI RREGULLATIV

Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për Ngrahoren e Qytetit Gjakova SH.A.
Sezoni i Ngrahjes 2022/2023

Prishtinë, dhjetor 2022



PËRMBAJTJA

1	Hyrje.....	3
2	Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore	4
3	Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara	6
3.1	Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara.....	7
3.2	Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB).....	13
3.2.1	Përcaktimi i Aseteve Ekzistuese	14
3.2.2	Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara	16
3.2.3	Përcaktimi i Kapitalit Punues	17
3.2.4	Tjetërsimet.....	17
3.3	Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor për sezonin 2021/2022	18
3.4	Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar).....	20
3.5	Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet.....	23
3.6	Përshtatja (Akhustimi)	23
3.7	Llogaritja e të Hyrave të Lejuara - Përmbledhje	23
4	Bilanci i Energjisë Termike	24

Figurat

Figura 1: Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara	5
Figura 2: Paraqitja skematike e kostove operationale të propozuara nga NQ Gjakova dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2021/2022	8

Tabelat

Tabela 1: Kostot e paraqitura nga ana e NQ Gjakova SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €).....	8
Tabela 2: Llogaritja e pjesëmarrjes së kategorive të veçanta të asetëve.....	14
Tabela 3: Alokimi i asetëve në asete që përkasin energjisë termike dhe energjisë elektrike.....	15
Tabela 4: Asetet në kuadër të projektit të SECO-s.....	16
Tabela 5: RAB dhe komponentët e tij - NQ GJAKOVA sezoni i ngrohjes 2022/2023.....	18
Tabela 6: RABf dhe komponentët e tij - NQ GJAKOVA sezoni i ngrohjes 2022/2023	18
Tabela 7: Detajet e kategorizimit të asetëve për të reflektuar normat e zhvlerësimit.....	19
Tabela 8: Përmbledhje e kategorizimit të asetëve (RAB) me normat përkatëse të zhvlerësimit	19
Tabela 9: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RABf për sezonin e ngrohjes 2022/2023	23
Tabela 10: Të Hyrat e lejuara për NQ GJAKOVA sezoni i ngrohjes 2022/2023	24
Tabela 11: Përmbledhje e Bilancit të energjisë termike.....	244



1 Hyrje

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë; këtu janë një sërë parimesh të gjera, siç janë parimet e mos-diskriminimit dhe arsyeshmërisë me të cilat ndërmarrjet e energjisë do të mund t'i rikthenin të gjitha kostot e arsyeshme përfshirë edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre. Gjithashtu nenet 18 dhe 19 të Ligjit për Energjinë Termike përcaktojnë se Furnizuesi me obligimin e shërbimit publik, kryen furnizimin me energji termike me tarifa të rregulluara.

Përderisa sektori i energjisë termike në transportimin dhe shpërndarjen e energjisë termike klasifikohet si monopol i natyrshëm, dhe për arsye se gjithashtu në gjenerim dhe furnizim ende nuk ekziston konkurrenca, atëherë tarifat e ngrohjes qendrore, që i përmbajnë të gjitha komponentët e lartpërmendura, i nënshtrohen përcaktimit - miratimit nga ZRRE-ja.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta ligjore, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike. Rregulla përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe Metodologjinë për llogaritjen e të hyrave të lejuara dhe tarifave.

Për përcaktimin e të hyrave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2022/2023 janë marrë parasysh si vijon:

- Informatat e dhëna nga NQ Gjakova në aplikacionin e tyre tarifor për sezonin e ngrohjes 2022/2023;
- Informatat tjera nga NQ Gjakova në kuadër të raportimeve rregullative për sezonin e kaluar; Lidhur me këtë duhet theksuar se të dhënat historike për NQ Gjakovën janë të mangëta për arsye të ndërrimit të teknologjisë së prodhimit të energjisë termike – konkretisht ngrohtorja e re me biomasë ka filluar operimin e rregullt në vitin 2021.

Ecuria e procesit të shqyrtimit tarifor:

- **Me 6 qershor 2022** – ZRRE ka lëshuar shkresën për njoftimin e fillimit të shqyrtimit të tarifave për NQ Gjakova për sezonin 2022/2023; kjo është pasuar me kërkesën e ZRRE-së për të dhëna dhe informata dërguar me 10 qershor 2022, ku janë përshkruar detajisht të dhënat dhe informatat që NQ Gjakova duhet dorëzuar për shqyrtimin tarifor, si dhe Planin dhe Orarin;
- **Me 23 gusht 2022** – NQ Gjakova përmes e-mailit ka dorëzuar aplikacionin tarifor preliminarë për sezonin 2022/2023 me disa nga të dhënat dhe informatat e kërkuara për shqyrtim tarifor – aplikacioni 'preliminarë' është dërguar me qëllim të kontrollimit paraprak nga ZRRE duke qenë se ky ka qenë shqyrtimi i parë tarifor pas një periudhe të gjatë;
- **Me 23 shtator 2022** – Pas analizimit dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave të dorëzuara nga NQ Gjakova, ZRRE ka dërguar komentet me shkrim, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të aplikacionit fillestarë;
- **Me 17 tetor 2022** – NQ Gjakova ka ri-dorëzuar aplikacionin me disa nga korrigjimet, përmirësimet dhe plotësimet e kërkuara në komentet e ZRRE-së, si dhe përgjigjet në komentet e ZRRE-së.



2 Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe të tarifave të energjisë termike për sezonin 2022/2023 është zbatuar Metodologjia e përcaktuar në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike.

Parimet

Parim bazë i kësaj metodologjie është se tarifat për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike duhet të mbulojnë të gjitha kostot e arsyeshme - operative dhe kapitale, kështu që në njërin anë konsumatorët nuk do të duhej të paguajnë më tepër se sa kostoja e shkaktuar për ofrimin e shërbimeve, ndërsa në anën tjetër ndërmarrja e shërbimeve publike duhet të mbulojë të gjitha kostot e arsyetuara plus një normë të arsyeshme të kthimit në investimet kapitale. Çmimi final i shërbimit zakonisht përcaktohet për të përfshirë të gjitha kostot operative të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike, d.m.th., të mbulojë koston e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit (operimi dhe mirëmbajtja, lënda djegëse, pagat, kostot e humbjeve në rrjet, shpenzimet e përbashkëta dhe administrative, etj.) plus një kthim të arsyeshëm në investimet që janë dedikuar ofrimit të shërbimit publik.

Duke qenë se në disa raste rregullimi i tillë nuk nxit ndërmarrjet për të ngritur efikasitetin operativ dhe të stimuloj kursimin e shpenzimeve, përkundrazi mund të nxisin mbi-investime në asete dhe gjithashtu, dhe duke marrë parasysh obligimin e Rregullatorit për të mbrojtur konsumatorët, kërkohet që ndërmarrjet jo vetëm të dëshmojnë "shpenzimet e arsyeshme" të deklaruara, por edhe të tregojnë një rritje të efikasitetit operativ dhe të kostove. Masat e tilla krijojnë bazë për bashkërendimin në fillim të shqyrtimit tarifor, në të cilën Rregullatori shpërblen apo ndëshkon ndërmarrjen për rritjen apo rënien e efikasitetit dhe kontrollit të kostos.

Formulimi

Me qëllim të llogaritjes së të Hyrave të lejuara dhe llogaritjes përfundimtare të tarifave, në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike (shtojcat 1,2,3, dhe 6) është dhënë në detaje formulimi i Metodologjisë tarifore. Megjithatë, për arsye konsistence, formulimi do të paraqitet shkurtimisht edhe në këtë raport.

Skematikisht, Metodologjia tarifore mund të tregohet si më poshtë. Kostot të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga kostot operative, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësoj asetet e veta, koston e humbjeve të rrjetit dhe kthimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), e cila në fakt paraqet fitimin për ndërmarrjen.




Figura 1: Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara

Formulat bazë të rregullimit:

Të hyrat e lejuara janë llogaritur sipas formulës:

$$\text{MAR} = \text{OPM} + \text{DEP} + \text{RTN} + \text{LOS} + \text{ADJ}$$

Ku:

- MAR** Të Hyrat e lejuara maksimale;
- OPM** Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes;
- DEP** Zhvlerësimi vjetor i lejuar;
- RTN** Kthimi i lejuar në asete;
- LOS** Kostoja e humbjeve në rrjet;
- ADJ** Përshtatja (axhustimi) i të hyrave.

Të Hyrat e lejuara paraqesin koston vjetore të kompanisë, e që përmbajnë: i) kostot operative, të cilat janë të "arsyetuara"; ii) zhvlerësimin vjetor; iii) Koston e humbjeve në rrjet; dhe iv) kthimin e lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).

Kostot operative përbehen nga pjesa fikse dhe ajo variabile, e formuluar si vijon:

$$\text{OC} = \text{OC}_f + \text{OC}_v$$

Kostot operative paraqesin kostot totale të arsyeshme të parashikuara për një vit, e që këtu hyjnë: i) kostot për lëndë djegëse, kostot e blerjes së energjisë termike dhe kostot tjera si energjia elektrike, kemikalet për trajtimin e ujit, pjesët rezervë; ii) kostot tjera operative të sistemit, riparimet dhe mirëmbajtja; dhe iii) kostot e personelit dhe kostot e përbashkëta. Kostot operative të lejuara nuk përfshijnë: i) subvencionet; ii) kostot e refuzuara nga autoritetet tatimore, dhe kostot e ndarjes së rezervave apo shpërndarjes së tyre; dhe iii) pagesat e qirasë për mjetet që nuk janë të shënuara në llogari-mbajtjen, shpenzimet financiare apo shpenzimet tjera te pa arsyetuar.

Baza e Rregulluar e Aseteve është llogaritur sipas formulës:



$$RAB_n^{p\acute{e}rf.} = RAB_n^{fill.} + INV_n + WC_n - DEP_{n-1} - DIS_{n-1}$$

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) paraqet asetet e ndërmarrjes të konsideruara për përdorim dhe të dobishme për ofrimin e shërbimit publik, e të cilat përfshijnë: i) Bazën e Rregulluar të Aseteve fillestar ($RAB_n^{fill.}$) që faktikisht paraqet RAB-in përfundimtarë të realizuar në sezonin paraprak 2021/22 (n-1); ii) investimet e reja kur janë të planifikuara dhe të aprovuara nga Rregullatori (INV_n); iii) kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të kryejë aktivitetet e saj (WC_n); Zhvlerësimin e asetëve të realizuar në sezonin paraprak 2021/22 (n-1) (DEP_{n-1}) dhe iv) Asetet e tjetërsuara (DIS_{n-1}).

ZRRE-ja, si Normë të Kthimit, ka marrë vlerën e WACC-ut (Mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit). WACC (%) është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit, dhe është llogaritur sipas formulës:

$$WACC = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

Ku:

D/V-	Pjesa e borxhit nga baza totale e kapitalit
E/V -	Pjesa e ekuitetit nga baza totale e kapitalit
V -	Baza totale e kapitalit, e cila është i gjithë ekuiteti dhe borxhi
k _d -	Kostoja e borxhit
k _e -	Kostoja e Ekuitetit

3 Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara të NQ Gjakova SH.A. për sezonin 2022/2023, në pajtim Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, ZRRE ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operative të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të lejuar në RAB (kthimit në investime), i cili përfshin:
 - a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i asetëve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi i investimeve të planifikuara dhe kapitalit punues; dhe
 - b) llogaritjen e Normës së kthimit të lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostos së lejuar për humbjet në rrjet.

Në përcaktimin e të Hyrave të lejuara, ZRRE ka marrë parasysh sa vijon:

- Informatat e ofruara nga NQ Gjakova në aplikacionin e tij për tarifën për sezonin e ngrohjes 2022/2023 – të dhënat rreth të ardhurave të parashikuara nga shitja e ngrohjes dhe nga shërbimet e tjera të ndërlidhura, kostot e parashikuara totale, asetet dhe investimet e planifikuara, prodhimin dhe furnizimin e parashikuar të ngrohjes, si dhe sipërfaqen ngrohëse të parashikuar;
- Informatat që ZRRE i ka siguruar nga raportimet rregullative të sezoneve / viteve të kaluara.

Duke e ditur se informatat e parashikuara janë thelbësore për përcaktimin e të Hyrave të lejuara, këto do të duhej të ishin të besueshme dhe reale. Përgjithësisht, në parashikimin / planifikimin e biznesit do të duhej të aplikohet qasje reale e përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve të shumtë që ndikojnë në biznes, p.sh., vlerësimi i tregut dhe parashikimi i zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vlerësimi i prodhimit / mundësitë e furnizimit dhe mundësitë financiare të kompanisë. Natyrisht,



parashikimi/planifikimi i drejtë duhet të bazohet në të dhënat që kompania i ka realizuar në të kaluarën gjatë një periudhe të caktuar.

Duhet cekur këtu se, aplikacioni tariforë preliminarë i NQ Gjakova ka qenë deri në një masë i kompletuar, si dhe gjithashtu në disa nga të dhënat dhe informatat që ka përmbajtur aplikacioni janë vërejtur pasaktësi, mos-përputhje dhe jo-konsistencë, të cilat, me disa përjashtime, janë përmirësuar sqaruar dhe plotësuar pas komenteve të ZRRE-së dhe takimeve të përbashkëta ZRRE-NQ Gjakova.

Në fakt, sa i përket informatave të parashikuara (siç është përcaktuar në Shtojcën 4 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, NQ Gjakova i ka dorëzuar ZRRE-së pasqyrat/tabelat që përshijnë të ardhurat dhe kostot e parashikuara, të dhëna teknike dhe të konsumatorëve, asetet operative dhe investimet e parashikuara, për periudhën një vjeçare që mbulon plotësisht sezonin e ngrohjes – periudha: 15 tetor 2022 – 14 tetor 2023. Ndërsa si dokumente mbështetëse ka dorëzuar: i) Raportin e auditorit dhe Pasqyrat financiare statusore për vitin 2021; ii) Listën e aseteve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare e blerjes së aseteve; iii) Planifikimet e Investimeve në periudhën njëvjeçare që përfshinë sezonin 2022/23; iv) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2022/2023, respektivisht zgjerimit të sipërfaqes ngrohëse të konsumatorëve.

ZRRE-ja ka bërë përpjekje dhe ka angazhuar ekspertizën në dispozicion për të bërë një vlerësim sa më real të informatave të parashikuara të dorëzuara nga ana e NQ Gjakovës. Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse dhe vlerësim i informatave të paraqitura. Lidhur me këtë duhet theksuar se mungesa e të dhënave historike për sezonet e kaluar ka paraqitur vështirësi shtesë sepse është pamundësuar krahasimi i të dhënave respektive nga sezonet e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi (parashikimi) i saktë i të hyrave të lejuara për sezonin 2022/2023.

3.1 Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara

Planifikimet për kostot operative të dorëzuara nga ana e NQ Gjakova për periudhën njëvjeçare që mbulon gjithë sezonin e ngrohjes 2022/2023, janë strukturuar si kosto variabël dhe fikse, e cila ndarje kryesisht është në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe me parimet e avancuara të kontabilitetit dhe me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Në këtë seksion do të tregohen në mënyrë tabelare shpenzimet e parashikuara siç janë prezantuar nga NQ Gjakova dhe shpenzimet operative të lejuara që ZRRE i ka aprovuar (Tabela 1.) Në vijim të tabelës është dhënë shpjegimi analitik për secilin pozicion të kostove operative.



Tabela 1: Kostot e paraqitura nga ana e NQ Gjakova SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €)

Kostot Operative Sezoni 2022/2023 /Alokimi për energji termike		Propozuar nga NQ Gjakova	Lejuar nga ZRRE
Kostot Variabile			
1	Lënda djegëse - prodhimi vetëm en. term. (HoB)	476,602	476,602
2	Lënda djegëse - Kogjenerimi (alokimi për en. term.)	413,285	413,285
3	Uji për rimbushjen e sistemit	13,721	13,721
4	Kemikaljet për trajtimin e ujit	601	601
5	Energjia elektrike (prodh. & Nënst. Distr.)	15,893	15,893
6	Kost. e personelit (puna direkte)	74,120	74,120
7	Taksa vjetore e licencave	1,467	1,467
8	Borxhi i keq i lejuar	19,402	19,402
9	Tjera variabile	0	0
10	Total kost. variabile	1,015,091	1,015,091
Kostot fikse			
11	Materialet, shërbimet	12,591	12,591
12	Riparimet e mirëmbajtja	376	376
13	Shpenzimet për administratë	9,939	9,939
14	Shpenzimet e personelit (te ndryshme nga puna direkte)	77,001	77,001
15	Kostot e shites dhe tjera administrative	0	0
16	Total kostot fikse	99,907	99,907
17	Totali i kostove operative	1,114,998	1,114,998
18	Kostot fikse	99,907	99,907
19	Kostot variabël	1,015,091	1,015,091





Figura 2: Paraqitja skematike e kostove operative të propozuara nga NQ Gjakova dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2022/2023



Detajet e kostove kryesore janë paraqitur grafikisht në vijim:



Shpjegim analitik

Në vijim janë dhënë shpjegime të detajuara dhe arsyetimet për përcaktimin / lejimin për secilin grup të kostove respektivisht për pozicionet kryesore të kostove operative.

Ngrohtarja e re me biomasë përveç dy njësive (kaldajave HoB) për prodhim vetëm të energjisë termike (ngrohjes) posedon edhe njësinë e ko-gjenerimit (CHP) të energjisë termike dhe elektrike e cila planifikohet të startoj këtë sezonë. Për këtë paraqitet nevoja e alokimit të kostove në kostot që i përkasin energjisë termike (ngrohjes) dhe energjisë elektrike, me qëllim që të evitohet çdo paraqitje e dyfishtë e kostove gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara dhe tarifave të ngrohjes. Alokimi i kostove të ko-gjenerimit është bërë në bazë të Metodologjisë në shtojcën 7 të Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike që ka përfshirë alokimin e kostove operative dhe atyre kapitale (aseteve); për këtë në fillim do paraqitet shkurtimisht metoda e alokimit të kostove.

- **Alokimi i kostove të ko-gjenerimit**

Siç përshkruhet në shtojcën 7, parim bazë për alokimin e kostove të ko-gjenerimit është raporti në mes të konsumit të lëndës djegëse në impiantin e ko-gjenerimit dhe konsumit të pre-supozuar të lëndëve djegëse në 'format alternative të prodhimit të energjisë'. Me 'format alternative' nënkuptohet teknologjitë tradicionale të prodhimit ndaras të energjisë termike dhe energjisë elektrike me të njëjtin kapacitet dhe që përdorin të njëjtë lëndë djegëse.

Pra gjatë llogaritjes së raportit (proporcionit) është marrë prodhimi i planifikuar i energjisë elektrike dhe asaj termike në njësinë e ko-gjenerimit, eficiencë e prodhimit e 'formave alternative' ashtu siç është specifikuar në shtojcën 7 – efienca e transformimit të energjisë nga lënda djegëse në energji elektrike (0.4) respektivisht termike (0.9).



Duke përdorur formulat e shtojcës 7 janë llogaritur proporcionet përkatëse në përqindje: proporcioni i konsumit të lëndës djegëse për prodhimin e energjisë elektrike $F_E=24.9\%$, dhe proporcioni konsumit të lëndës djegëse për prodhimin e energjisë termike (ngrohjes) $F_H=75.1\%$.

Ky proporcion mandej është përdorur për të bërë ndarjen e kostove operative (variabile dhe fikse); konkretisht, pasi që subjekti i shqyrtimit tarifar është energjia termike, atëherë kostot e përgjithshme operative janë shumëzuar me $F_H=75.1\%$ duke rezultuar me kostot e ndara për energji termike (ngrohje). Rrjedhimisht kostot operative në tabelën 1 dhe në shpjegimet vijuese janë paraqitur të alokuara për energjinë termike (ngrohjen).

Afërsisht e njëjta qasje është përdorur edhe për alokimin e aseteve në asete të alokuara për energji termike dhe elektrike-me qëllim të llogaritjes së kostove kapitale. Fillimisht janë ndarë asetet që nga aspekti teknologjik i përkasin energjisë termike dhe energjisë elektrike, dhe janë llogaritur proporcionet përkatëse në raport me totalin e aseteve; këto proporcione respektive janë përdorur për alokimin e aseteve mbështetëse/të përbashkëta në asete që i përkasin energjisë termike përkatësisht energjisë elektrike. Detajet për alokimin e aseteve janë dhënë në Kapitullin 3.2

Kostot variabile:

- **Kostoja e lëndës djegëse – biomasë (ashkla druri):**
 - Kostoja e biomasës e propozuar nga NQ Gjakova në vlerë prej 889,887 € është bazuar në sasinë e parashikuar të shpenzimit të biomasës 7,026 ton dhe çmimit të blerjes prej 168.47 €/ton. Duke qenë se sasia e parashikuar e biomasës përfshinë sasinë totale për prodhim të energjisë termike dhe elektrike, kjo kosto është reduktuar me koeficientin e alokimit për energji termike (75.1%) që ka rezultuar në vlerën e propozuar.
 - Vlerësimi – Sasia e parashikuar e konsumit të lëndës djegëse – biomasës – është derivuar nga Bilanci i përgjithshëm i energjisë (që ka përfshirë energjinë termike dhe elektrike), ndërsa çmimi i blerjes së biomasës është dokumentuar me kontratën për furnizim me biomasë. Duke përdorur metodologjinë e lartë-përshkruar të alokimit, ZRRE ka ri-kalkuluar edhe njëherë sasinë e planifikuar të lëndës djegëse për energjinë termike, me qëllim që të hartoj Bilancin vetëm të energjisë termike (ngrohjes), për të specifikuar përcaktuesit e faturimit. Ky ri-kalkulim ka rezultuar me sasinë e biomasës vetëm për energji termike në sasi prej 5,282.17 ton, që e shumëzuar me çmimin e blerjes (168.47 €/ton) rezulton në **koston për biomasë prej 889,887€**, e cila lejohet për këtë shqyrtim tarifar.
- **Kostoja e ujit për (ri)mbushjen e sistemit të ngrohjes dhe kemikaljeve për trajtimin e ujit:**
 - NQ Gjakova ka propozuar koston në vlerë prej 13,721 €, për sasinë e parashikuar të shpenzimit të ujit për rimbushje të sistemit të shpërndarjes (rrjetit primarë), si dhe koston për kemikaljet e trajtimit të ujit në vlerë prej 601 €.
 - Vlerësimi – Duke marrë parasysh konsumin e nevojshëm të ujit për rimbushjen e zakonshme të sistemit, e gjithashtu duke konsideruar një pjesë të humbjeve në rrejt për shka të rrjedhjeve të ujit, ZRRE vlerëson se kostot e paraqitura janë të arsyeshme; rrjedhimisht ZRRE pranon **koston e propozuar të ujit prej 13,721 € dhe të kemikaljeve në vlerë prej 601 €**.
- **Kostoja e energjisë elektrike**
 - Për koston e energjisë elektrike NQ Gjakova ka propozuar vlerën totale prej 15,893 € - kjo kosto merr parasysh konsumin e energjisë elektrike në impiantet e sistemit dhe në një numër të



nënstacioneve (zakonisht në ndërtesa e vjetra të banimit kolektiv. Duhet theksuar se vlera e propozuar e kostos së energjisë elektrike paraqet se vetë pjesën e konsumit i cili nuk do të mund të mbulohej nga prodhimi vetanak (nga njësisia e CHP) dhe duhet të merret nga rrjeti i energjisë elektrike.

- Vlerësimi – ZRRE vlerëson se përllogaritja e konsumit të energjisë elektrike dhe ndarja në pjesën që mbulohej nga konsumi vetanak dhe në pjesën që duhet marrë nga rrjeti elektrik respektivisht nga Furnizuesi, është e bazuar dhe reale; prandaj e pranon koston e paraqitur të energjisë elektrike në vlerë prej 15,893 €.
 - **Kostoja e Personelit (“puna direkte”)**
 - NQ Gjakova ka paraqitur koston e personelit – “puna direkte”, në vlerë prej 74,120 € (pjesa e alokuar për energji termike nga shuma 98,674€), që mbulon pagat bruto dhe kontributin pensional për 16 anëtarë të stafit të angazhuar drejtpërdrejt në prodhim dhe shpërndarje.
 - Vlerësimi – Për të vlerësuar koston e personelit të paraqitur nga NQ Gjakova, ZRRE i është referuar Raportit të auditorit për pasqyrat financiare për vitin 2021. Në këto pasqyra financiare vërehet se shuma totale e ‘shpenzimeve të personelit’ për vitin 2021 është 201,185 € - pagat bruto: 191,776 dhe kontributet pensional të pagueshme nga punëdhënësi: 9,409 €. Duke marrë parasysh edhe koston e personelit të paraqitur për stafin administrativ e menaxherial, atëherë ZRRE vlerëson se kostoja e personelit e paraqitur nga NQ Gjakova korrespondon me shumën e ‘shpenzimeve të personelit’ në pasqyrat financiare të audituara për vitin 2021. ZRRE rrjedhimisht lejon **Koston e personelit – ‘Puna direkte’** në vlerë prej 74,120 €.
 - **Kostoja e Borxheve të këqija dhe taksa vjetore e licencimit**
 - NQ Gjakova nuk e ka paraqitur koston e borxheve të këqija në pasqyrën rregullative ‘b’ por në Raportin shpjegues ka paraqitur këtë kosto në vlerë 19,402 €, përderisa ka specifikuar normën lejuar prej 5% nuk ka specifikuar shumën e përdorur për llogaritje. ZRRE ka përllogaritur shumën 388,040 €, që e shumëzuar me 5%, jep vlerën e propozuar të borxhit të keq. NQ Gjakova gjithashtu nuk ka paraqitur kostoja e taksës vjetore të licencimit.
 - Vlerësimi - Në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, kostoja e borxhit të keq llogaritet si përqindje e arsyeshme në të hyrat e ndërmarrjes (d.m.th. vlerën e faturimit nga shitja e ngrohjes e realizuar nga sezoni i kaluar). Kjo ‘përqindje e arsyeshme’ duhet të caktohet në atë mënyrë që të nxis ndërmarrjen për të shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të arkëtimit të pagesave nga konsumatorët, por njëkohësisht merr parasysh se një shumë e konsiderueshme objektivisht nuk mund të arkëtohet, pra do të mbetet si borxh që faktikisht nuk do të realizohet. Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se niveli i borxhit të keq prej 5% është i arsyeshëm, dhe rrjedhimisht e lejon koston e borxhit të keq në vlerën prej 19,402 €.
- Sa i përket taksës së licencimit duhet theksuar se taksa vjetore e licencimit llogaritet bazuar në Rregullën e ZRRE-së për taksat që për prodhimin e energjisë nga BRE-të është e përcaktuar 10% e prodhimit neto. Nisur nga kjo ZRRE ka llogaritur taksën vjetore të licencimit në vlerë 1,467 € - për sasinë e prodhimit neto të energjisë termike 14,674 MWh.



Nga më lartë rezulton se **Kostot Variabile** të pranuar nga ZRRE-ja janë përcaktuar në vlerën **1,015,091€**.

Kostot fikse

- **Kostoja: Riparimet dhe Mirëmbajtja;**
 - NQ Gjakova për koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes ka planifikuar një vlerë minimale prej 376€ - kjo për faktin se impianti i ngrohtores është i ri, i sapondërtuar dhe në periudhën e garancionit nga kontraktuesi.
 - Vlerësimi – Duke marrë parasysh arsyetimin e cekur më lartë, ZRRE e pranon koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes në vlerën prej **376 €**.
- **Kostoja: Materialet dhe Shërbimet:**
 - Për këtë pozicion nga NQ Gjakova është propozuar një vlerë prej 12,591 € për blerjen e materialeve të ndryshme për prodhim dhe rrjetin e shpërndarjes, e gjithashtu karburantet dhe shërbimet e servisimit për automjetet e terrenit;
 - Vlerësimi – Duke marrë parasysh se vlera e propozuar i referohet vlerave kontabël të kostove të përshkruara për periudhat e kaluara, ZRRE lejon koston '**Materialet dhe Shërbimet**' në vlerë prej **12,591 €**.
- **Kostot Administrative:**
 - NQ Gjakova ka propozuar koston për administratë në vlerë prej 9,939 €, që reflektojnë shpenzimet e zakonshme për materialet e zyrës, të teknologjisë informative dhe komunikimit,
 - Vlerësimi – ZRRE vlerëson shumën e paraqitur si të arsyeshme për të mbuluar kostot për shërbimet e zakonshme administrative dhe e pranon koston e propozuar në vlerën **9,939€**.
- **Kostoja e Personelit ('e ndryshme prej punës direkte')**
 - Për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera mbështetëse NQ Gjakova NQ Gjakova ka paraqitur koston në vlerë prej 77,001 € (pjesa e alokuar për energji termike nga shuma 102,509€), që mbulon pagat bruto dhe kontributin pensional për stafin e administratës dhe menaxherial.
 - Vlerësimi – Për të vlerësuar koston e personelit të paraqitur nga NQ Gjakova, ZRRE i është referuar Raportit të auditorit për pasqyrat financiare për vitin 2021. Në këto pasqyra financiare vërehet se shuma totale e 'shpenzimeve të personelit' për vitin 2021 është 201,185 € - pagat bruto: 191,776 dhe kontributet pensional të pagueshme nga punëdhënësi: 9,409 €. Duke marrë parasysh edhe koston e personelit 'puna direkte' të paraqitur për stafin e angazhuar drejtpërdrejt në prodhim dhe shpërndarje, atëherë ZRRE vlerëson se kostoja e personelit e paraqitur nga NQ Gjakova korrespondon me shumën e 'shpenzimeve të personelit' në pasqyrat financiare të audituara për vitin 2021. ZRRE rrjedhimisht lejon **Koston e personelit – 'e ndryshme nga puna direkte'** në vlerë prej **77,001 €**.

Nga më lartë rezulton se **Kostot Fikse** të pranuar / lejuara nga ZRRE-ja, janë përcaktuar në vlerën **99,907 €**.



- Total Kostot operative të lejuara për sezonin 2022/2023

Kostot operacionale përbëhen nga shuma e kostove fikse dhe atyre variabël, dhe janë llogaritur sipas formulës së shënuar më poshtë:

$$\text{OC} = \text{Kostot Variabile} + \text{Kostot Fikse}$$

Nga formula llogariten:

Kostot operative në vlerë prej 1,114,998 €

Në rastet kur ndërmarrja pranon subvencione për operim (si p.sh. për blerjen e lëndës djegëse), atëherë sipas praktikave rregullative vlera e subvencionimit zbritet nga vlera e kostove operative, për arsye se ndërmarrja nuk ngarkohet me një kosto apo një pjesë të kostos e cila mbulohet nga subvencioni.

Bazuar në ndarjet buxhetore nga Ministria e Ekonomisë për vitin 2022, ndarjen e planifikuar në Projektligjin për buxhetin e vitin 2023, si dhe zotimin nga Komuna e Gjakovës për subvencionim shtesë në vitin 2023, ZRRE vlerëson se shuma e subvencionimit për NQ Gjakovën për sezonin 2022/2023 është 650,000 €; kjo shumë zbritet nga Kostot operative, rrjedhimisht **Kostot Operative të lejuara llogariten:**

$$\text{OC}_{\text{LEJ}} = 1,114,998 \text{ €} - 650,000 \text{ €} = 464,998 \text{ €}$$

3.2 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)

Përcaktimi i RAB-it është komponenti kryesor për llogaritjen e Zhvlerësimit vjetor dhe Kthimit të lejuar në asete, që në fakt paraqet fitimin e lejuar nga aktiviteti afarist i rregulluar.

Baza e Rregulluar e Aseteve - RAB, në pajtim me shtojcën 2 të Rregullës për vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike llogaritet sipas formulës:

$$\text{RAB}_n^{\text{perf.}} = \text{RAB}_n^{\text{fill.}} + \text{INV}_n + \text{WC}_n - \text{DEP}_{n-1} - \text{DIS}_{n-1}$$

ku:

$\text{RAB}_n^{\text{perf.}}$ – paraqet asetet e planifikuara për sezonin 2022/23 ('n');

$\text{RAB}_n^{\text{fill.}}$ – Bazën e Rregulluar të Aseteve fillestarë, që faktikisht paraqet RAB-in përfundimtarë të realizuar në sezonin paraprak 2021/22 ('n-1');

INV_n – Investimet e reja të planifikuara dhe të aprovuara nga rregullatori për periudhën njëvjeçare që përfshinë sezonin e ngrohjes 2022/2023;

WC_n – Kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të kryejë aktivitetet e saj;

DEP_{n-1} – Zhvlerësimin e asetëve të realizuar në sezonin paraprak 2021/22 ('n-1'); dhe

DIS_{n-1} – Asetet e tjetërsuara në sezonin paraprak 2021/2022 ('n-1').

Duke qenë se në këtë sezon zhvillohet procesi i shqyrtimit tarifor pas një periudhe shumëvjeçare, gjatë së cilës asetet e NQ Gjakova kanë pësuar ndryshime të dukshme në strukturë dhe në vlerën monetare, kryesisht për shkak të investimeve në projektin e EU-së Ngrohtorja e re dhe njësia e ko-gjenerimit me biomasë dhe në projektin e SECO-së për rehabilitimin e rrjetit dhe nënstacioneve termike, atëherë



konsiderohet se përcaktohet RAB-i për herë të parë, dhe rrjedhimisht formula modifikohet si më poshtë:

RAB = Vlera Neto Kontabël e Aseteve Ekzistuese (pas Zhvlerësimit të akumuluar) + INV (Investimet e reja) + WC (Kapitali Punues) – DIS (Tjetërsimet).

3.2.1 Përcaktimi i Aseteve Ekzistuese

Lidhur me asetet ekzistuese fillimisht duhet theksuar se, NQ Gjakova me të drejt nuk ka paraqitur asetet e vjetra – ngrrohtoren e vjetër me mazut dhe rrjetin e shpërndarjes, për këto arsye:

- Ngrrohtorja e vjetër me mazut përveç faktit se ka qenë në gjendje të keqe teknike dhe gati plotësisht e zhvlerësuar, kjo ngrrohtore aktualisht nuk përdoret për prodhimin e energjisë termike respektivisht për ofrimin e shërbimit që është subjekt i këtij shqyrtimi tarifor; rrjedhimisht ky asetet nuk mund të përfshihet në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).
- Po ashtu edhe pjesa më e madhe e rrjetit të shpërndarjes përfshirë edhe nënstacionet ka qenë në gjendje teknike dhe e zhvlerësuar gati tërësisht, dhe për këtë shkak i janë nënshtruar rehabilitimit (zëvendësimit me tubacion dhe pajisje të reja) në kuadër të projektit të SECO-s.

Nga sa u tha më lartë përcaktimi i asetëve ekzistuese do të përmbaj:

- a) Asetet e Investuara në kuadër të projektit të EU-së: Ngrrohtorja e re dhe njësia e ko-gjenerimit me biomasa; dhe
- b) Asetet e Investuara në kuadër të projektit të SECO-s: Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve termike.

a) Asetet e Projektit EU-së: Ngrrohtorja e re dhe njësia e ko-gjenerimit me biomasa

Për vlerësimin e këtyre asetëve janë shfrytëzuar të dhënat / dokumentacioni i projektit, që gjithashtu janë paraqitur nga NQ Gjakova në Pasqyrën 'A' dhe dokumentin shpjegues. Total asetet e ngrrohtores së re dhe njësisë së ko-gjenerimit janë vlerësuar në shumën 12,632,507 € (ref. tabela 3).

Për shkak të njësisë së ko-gjenerimit asetet totale i janë nënshtruar edhe ndarjes (alokimit) përkatëse në asete të alokuara për energjinë termike (ngrohjen) dhe energjinë elektrike, ku është përdorur një qasje afërsisht e njëjtë me alokimin e kostove operative. Sipas metodologjisë së përdorur fillimisht janë identifikuar asetet që ekskluzivisht i përkasin energjisë termike (si p.sh. kaldajat për prodhimin vetëm energjisë termike – HoB) respektivisht asaj elektrike (si p.sh. turbina, gjeneratori) dhe asetet e përbashkëta përkatësisht mbështetëse (si ndërtesa e ngrrohtores e administrative, sistemi i menaxhimit lëndës djegëse, sistemi trajtimit të ujit etj.). Vlerat dhe detajet e llogaritjes në tabelën vijuese:

Tab. 2: Llogaritja e pjesëmarrjes së kategorive të veçanta të asetëve

Nr.	Përshkrimi	Vlera (€)	Pjesëmarrja (në %)
1	Asetet që ekskluzivisht i përkasin energjisë termike	2,225,774 €	47.02 %
2	Asetet që ekskluzivisht i përkasin energjisë elektrike	2,508,000 €	52.98 %
3	Totali	4,733.774 €	100 %



Pjesëmarrjet të llogaritura në përqindje për secilën kategori do të shërbejnë si koeficient të alokimit të aseteve të përbashkëta / mbështetëse në kategoritë përkatëse – 47.02 % për energji termike (ngrohje), dhe 52.98% për energji elektrike.

Detajet e alokimit në tabelën '3' më poshtë:

Tab. 3: Alokimi i aseteve në asete që i përkasin energjisë termike dhe energjisë elektrike

Asetet në kuadër të Projekti EU-së: Ngrohitorja e re dhe njësia e kogjenerimit me biomasë					
Kategoria	Vlera totale [€]	Alokimi në [%]		Vlera e alokimit [€]	
		En. Termike	En. Elektrike	En. Termike	En. Elektrike
1. Asetet që i përkasin vetëm en. termike	2,225,774	100.00%	0.00%	2,225,774	0
Kaldajat (HoB) për prodhimin e en. termike 2x5.5 MW _{TH}	1,403,110	100.00%	0.00%	1,403,110	0
Segmenti tubac. Ng.e Re - kyqja në rrjetin e shpërnd.	742,664	100.00%	0.00%	742,664	0
Rrjeti ujësjellësit e kanalizimit	80,000	100.00%	0.00%	80,000	0
2. Asetet që i përkasin vetëm en. Elektrike	2,508,000	0.00%	100.00%	0	2,508,000
Turbina + Gjeneratori + tubacionet e qarku ujë-avull (CHP)	2,028,000	0.00%	100.00%	0	2,028,000
Transformatori	280,000	0.00%	100.00%	0	280,000
Linja për kyqje në rrjetin e shpërndarjes en. elektrike	200,000	0.00%	100.00%	0	200,000
3. Asetet e Përbashkëta / Mbështetëse	7,898,733	47.02%	52.98%	3,713,907	4,184,827
Ndërtesa e ngrohtores dhe njësisë kogjenerimit (CHP)	1,265,446	47.02%	52.98%	595,000	670,446
Ndërtesa administrative	269,675	47.02%	52.98%	126,799	142,877
Depoja e pjesëve rezervë dhe punëtorja	287,904	47.02%	52.98%	135,370	152,534
Kaldaja e njësisë së kogjenerimit (CHP)	2,579,445	47.02%	52.98%	1,212,830	1,366,615
Pompa qarkulluese	1,109,750	47.02%	52.98%	521,794	587,956
Pajisjet tjera të njësisë së kogjenerimit	165,295	47.02%	52.98%	77,720	87,575
Instalimet elektro-mekanike	411,090	47.02%	52.98%	193,290	217,800
Pajisjet kontrolluese	197,825	47.02%	52.98%	93,015	104,810
Sistemi i trajtimit të ujit	302,624	47.02%	52.98%	142,291	160,333
Sistemi ekspandues i mbajtjes së shtypjes	153,435	47.02%	52.98%	72,144	81,291
Sistemi i menaxhimit të lëndës djegëse (l.d.) dhe rivendosi emergjent të furnizimit me energji elektrike	575,235	47.02%	52.98%	270,470	304,765
Sistemi e deponimit energjisë dhe makineritë bartëse të l.d.	571,010	47.02%	52.98%	268,483	302,527
Rrjeti i telekomunikimit	10,000	47.02%	52.98%	4,702	5,298
Total vlera e aseteve	12,632,507			5,939,681	6,692,827

Pra siç vërehet nga tabela 3, vlera e aseteve të alokuara për energji termike (ngrohje) është 5,939,681€.

b) Asetet e projektit të SECO-s: Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve termike

Në kuadër të projektit të SECO-s, këtë vit janë finalizuar punimet në dy komponentët kryesorë:

- **Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes në vlerë 2,172,164 €, që ka përfshirë:**
 - Rehabilitimin e degës veriore, ku është kryer rinovimi i plotë duke zëvendësuar gypat ekzistues të çelikut me gypa të rij të para-izoluar - 9,700 m gypë të para-izoluar në total me dimensione nga DN32 gjer DN300, si dhe i 360 valvulave të para-izoluara me dimensione nga DN40 gjer DN300
 - Rehabilitimi i degës jugore të rrjetit, ku kryesisht janë ndërmarrë riparimet e rrjedhjeve të ujit, në segmente të ndryshme të kësaj pjese të rrjetit; dhe
 - Instalimi i valvulave të segmentimit të rrjetit dhe pajisjeve të balancimit hidraulik për të dy degët e rrjetit.
- **Rehabilitimi i nënstacioneve termike në vlerë 1,016,232 €, që ka përfshirë:**
 - Rehabilitimin e 342 nënstacioneve ekzistues – 226 nënstacione kryesisht në shtëpi individuale dhe 116 nënstacione në ndërtesa të banimit kolektiv dhe objekte komerciale e Institucione të ndryshme; dhe



- Instalimi i 9 nënstacioneve të reja në ndërtesa publike.

Detajet e këtyre dy komponentëve me vlerat respektive janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tab. 4: Asetet në kuadër të Projektit të SECO-s

Projekti SECO-s: Rehabilitimi i Rrjetit dhe Nënstacioneve Termike			
Komponenta: Rehabilitimi i Rrjetit të shpërndarjes			
Përshkrimi	Vlera [€]		
Punimet preliminare dhe përgatitore - demolimi i 3,110 m kanale dhe 66 shahta të betonit	140,155		
Furnizimi i gypave dhe pajisjeve përcjellëse - 9,700 m gyp DN32-DN300 dhe 360 valvula DN40-DN300	1,188,348		
Punimet në instalimin e gypave dhe pajisjeve përcjellëse	444,407		
Punimet ndërtimore	384,547		
Pjesët rezervë	14,707		
Nëntotal	2,172,164		
Komponenta: Rehabilitimi i Nënstacioneve Termike		Nr. NST	Vlera [€]
Rehabilitimi i pjesës primare me matësa të energjisë termike dhe rregulatorë të rrjedhjes	226	180,670	
Rehabilitimi i pjesës primare me matësa të energjisë termike dhe rregulatorë të presionit, temperaturës dhe rrjedhjes	99	493,949	
Rehabilitimi i pjesës primare me matësa të energjisë termike dhe rregulatorë të presionit, temperaturës dhe rrjedhjes, plus shkëmbyesit e nxehtësisë	26	341,613	
Nëntotal	351	1,016,232	
Total		3,188,396	

Duhet theksuar se, për sa i përket alokimit, këto asetet i përkasin ekskluzivisht energjisë termike, pra alokohen 100% në asete të energjisë termike (ngrohjes).

Përmbledhje e asetëve ekzistuese

Asetet ekzistuese të alokuara për energji termike përbëhen nga asetet e investuara përmes dy projekteve, në vlerë totale:

- Asetet e projektit EU: Ngrohtorja e re dhe njësia e kogjenerimit me biomasë:	5,939,681 €
- Asetet e projektit SECO: Rehabilitimi i rrjetit dhe nënstacioneve termike:	3,188,396 €
- Total Asetet ekzistuese:	9,128,077 €

Mënyra e financimit:

Të gjitha asetet ekzistuese janë donacion të financuara përmes projekteve të EU-së dhe SECO-s.

3.2.2 Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara

Në Investimet e reja të planifikuara për periudhën e shqyrtimit tarifor: tetor 2022 – tetor 2023, është paraqitur vetëm një projekt: Rinovimi i Sistemit SCADA në vlerë 192,000 € si donacion në kuadër të projektit të SECO-s.

Sistemi ekzistues SCADA mbulon vetëm operimin e ngrohtores pa marrë në konsideratë kërkesën nga konsumatorët e rrjedhimisht dhe performancën e rrjetit të shpërndarjes. Kështu që është e nevojshme



të zgjerohet dhe rinovohet sistemi SCADA i ngrohtores për të përfshirë rrjetin dhe nënstacionet. Rinovimi i sistemit SCADA për të përfshirë rrjetin e shpërndarjes dhe nënstacionet termike do të siguroj shfrytëzimin optimal të sistemit të ngrohjes qendrore.

Rinovimi i sistemit SCADA përfshinë:

- 'harduerin' dhe 'softuerin' përkatës të SCADA-s;
- Pajisjen e rrjetit hidraulik për sistemin e shpërndarjes përfshirë softuerin e kalkulimit hidraulik të rrjetit; dhe
- Pagesat për licencat, pakon GSM etj.

Ky projekt është i paraqitur në Planin zhvillimorë të sistemit të NQ Gjakovës i cili është aprovuar nga ZRRE. Gjithashtu duhet theksuar se rinovimi i sistemit SCADA për të përfshirë rrjetin e shpërndarjes dhe nënstacionet termike është me rëndësi për të optimizuar sistemin e ngrohjes qendrore në tërësi, duke ndërlidhur të dhënat nga konsumatorët (kërkesën për ngrohje dhe kapacitet) me të dhënat nga performanca hidraulike e rrjetit të shpërndarjes.

Duke ju referuar këtyre detajeve të projektit, ZRRE pranon këtë projekt nën Investimet e reja për periudhën e shqyrtimit tarifor, në vlerën e paraqitur prej 192,000 €.

3.2.3 Përcaktimi i Kapitalit Punues

Sipas dispozitave përkatëse të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike – Shtojca 2, kapitali punues zakonisht përcaktohet për të lejuara mjete monetare qarkulluese për një periudhë jo më të gjatë se një muaj respektivisht vlerën e të hyrave mesatare mujore. Rrjedhimisht, ZRRE përcakton raportin 1/12 në të hyrat nga shitja e ngrohjes të realizuara në sezonin e kaluar 2021/2022 – 388,040 €, dhe lejon kapitalin punues në vlerën 32,337 €.

3.2.4 Tjetërsimet

Me tjetërsim nënkuptohen asetet që ndërmarrja e rregulluar i ka hequr nga përdorimi – asetet që janë dëmtuar në atë masë sa që nuk mund të riparohen dhe të përdoren përsëri, asetet që eventualisht janë shitur/huazuar (kur janë vlerësuar të papërdorshme) etj.; Sipas formulës së dhënë në fillim të kapitullit 3.2, vlera e asetëve të tjetërsuara është e zbritshme (minusohet). Siç u theksua në fillim të këtij kapitulli, NQ Gjakova nuk ka paraqitur, si asete ekzistuese, asetet e vjetra – ngrohoren e vjetër me mazut dhe rrjetin e shpërndarjes, atëherë tjetërsimet nuk merren parasysh në këtë shqyrtim tarifor.

Përmbledhje e përcaktimit të RAB-it dhe RAB_f

Në tabelën vijuese paraqiten të përmbledhura komponentët përbërës dhe vlerat respektive të Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) dhe Bazës së Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara (RAB_f).



Tabela 5: RAB dhe komponentët e tij - NQ Gjakova, sezoni i ngrohjes 2022/2023

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) - NQ GJAKOVA Sezoni i ngrohjes 2022-2023		Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Vlera Neto e Aseteve Ekzistuese	9,128,077
3.2.2	Investimet e Reja (INV _n)	192,000
3.2.3	Kapitali Punues (WC _n)	32,337
	Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)	9,352,414

Lidhur me Bazën e Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara (RAB_f) duhet theksuar se vlejën të njëjtat formulime si për RAB-in e përgjithshëm, porse këtu merren vlerat e asetëve/investimeve të vetëfinancuara; detajet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6: RAB_f dhe komponentët e tij - NQ Gjakova sezoni i ngrohjes 2022/2023

Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RAB _f)- NQ GJAKOVA Sezoni i ngrohjes 2022-2023		Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Vlera Neto e Aseteve Ekzistuese - të vetëfinancuara	0
3.2.2	Investimet e Reja (të vetëfinancuara - pa donacione) (INV _{f,n})	0
3.2.3	Kapitali Punues (WC _n)	32,337
	Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RAB_f)	32,337

3.3 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor për sezonin 2022/2023

Përcaktimi i Zhvlerësimit vjetor për sezonin 2022/23 ('n') bazohet në vlerën e RAB-it total të përcaktuar në tabelën '5' (kapitulli '3.2') dhe në mesataren e ponderuar të normës së zhvlerësimit.

Për të përcaktuar mesataren e ponderuar të normës së zhvlerësimit ka qenë e nevojshme kategorizimi i asetëve sipas karakteristikave të asetëve që korrespondojnë me normat përkatëse të zhvlerësimit; ky kategorizim është paraqitur detajisht në tabelën '7' më poshtë:



Tab. 7: Detajet e kategorizimit të aseteve për të reflektuar normat e zhvlerësimit

Kategorizimi i Aseteve të NQ Gjakova - sezoni 2022/2023				
Kategoria e aseteve	Përshkrimi	Vlera totale [€]	Alokimi En. Termike [€]	Alokimi En. Elektrike [€]
Asetet e Projektit EU - Ngrrohtëria e re dhe njësiat e kogjenerimit me Biomasi				
Ndërtesat	Ndërtesa e ngrrohtës dhe njësisë kogjenerimit (CHP)	1,265,446	595,000	670,446
	Ndërtesa administrative	269,675	126,799	142,877
	Depoja e pjesëve rezervë dhe punëtorja	287,904	135,370	152,534
Total Ndërtesat		1,823,025	857,169	965,857
Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike	Kaldajat (HoB) për prodhimin e en termike 2x5.5 MWTH	1,403,110	1,403,110	0
	Kaldaja e njësisë së kogjenerimit (CHP)	2,579,445	1,212,830	1,366,615
	Turbina + Gjeneratori + tubacionet e qarkut ujë-avull (CHP)	2,028,000	0	2,028,000
	Transformatori	280,000	0	280,000
	Pompa qarkulluese	1,109,750	521,794	587,956
	Pajisjet tjera të njësisë së kogjenerimit	165,295	77,720	87,575
	Instalimet elektro-mekanike	411,090	193,290	217,800
	Sistemi I trajtimit të ujit	302,624	142,291	160,333
	Sistemi ekspandues I mbajtjes së shtypjes	153,435	72,144	81,291
	Sistemi I menaxhimit të lëndës djegëse (l.d.) dhe rivendosjes emergjent të furnizimit me energji elektrike	575,235	270,470	304,765
Total Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike		9,578,994	4,162,132	5,416,862
Rrjetet	Segmenti tubac. Ng.e Re - kyqja në rrjetin e shpërnd.	742,664	742,664	0
	Linja për kyqje në rrjetin e shpërndarjes en. elektrike	200,000	0	200,000
	Rrjeti ujësjellësit e kanalizimit	80,000	80,000	0
Total Rrjetet		1,022,664	822,664	200,000
Pajisjet TI, sist. Kontr. dhe Inv. zyrës	Pajisjet TI dhe Sistemet kontrolluese	197,825	93,015	104,810
	Rrjeti I telekomunikimit dhe pajisjet përkatëse	10,000	4,702	5,298
Total pajisjet IT e sistemet kontrolluese		207,825	97,717	110,108
Total asetet e Proj. EU-së - Ngrrohtë. e re dhe njësiat e kogjen. mebiomasë		12,632,504	5,939,682	6,692,827
Asetet e Projektit SECO-s - Rehabilitimi i rrjetit dhe nënstationeve				
Rrjeti	Tubacionet, fittingjet, valvulat dhe pajisjet përkatëse	2,172,164	2,172,164	0
Pajisjet	Pajisjet e nënstationeve	1,016,232	1,016,232	0
Total Asetet e Projektit SECO-s - Rehabilitimi i rrjetit dhe nënstationeve		3,188,396	3,188,396	0
Total Asetet Ekzistuese të NQ Gjakova		15,820,904	9,128,078	6,692,827
Investimet e reja të planifikuara				
Pajis. TI & Sis. Kontr.	Rinovimi i sistemit SCAD për të përfshirë rrj. e shp. dhe nënst.	192,000	192,000	0
Total Investimet e reja - pajisje TI dhe sisteme kontrolluese		192,000	192,000	0
Total Asetet Ekzistuese dhe investimet e Reja		16,012,904	9,320,078	6,692,827

Në tabelën 8 është dhënë në mënyrë të përbledhur kategorizimi i RAB-it sipas kategorive të aseteve, jetëgjatësia respektive gjegjësisht norma e zhvlerësimit për secilën kategori të aseteve, si dhe norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit.

Tab. 8: Përbledhje e kategorizimit të aseteve me normat përkatëse të zhvlerësimit

Kategoritë e Aseteve	Vlera [€]	Jetëgjatësia (vite)	Norma e Zhvlerësimit [%]
Ndërtesat	857,169	40	2.50%
Stabilimentet, pajisjet dhe instalimet elektro-mekanike	5,178,364	25	4.00%
Rrjetet - tubacionet, fittingjet dhe pajisjet përbërëse	2,994,828	35	2.86%
Pajisjet TI, Sistemet kontrolluese, dhe invent. imët i zyrës	289,717	5	20.00%
Total Asetet (RAB-Kap. Pun.) Mes. e Pond. Normës Zhvlerësimit	9,320,078		3.99%

Siç vërehet nga tabela më lartë norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit (NZH_{MP}) është llogaritur 3.99%. Bazuar në vlerën totale të (RAB-it minus Kapitali punues) dhe Normën mesatare të ponderuar të zhvlerësimit, llogaritet Zhvlerësimi vjetor i lejuar, si në vijim:

$$\text{Zhvlerësimi vjetor i lejuar (DEP}_n\text{)} = (\text{Total RAB} - \text{WC}_n) * \text{NZH}_{MP} = 9,320,078 \text{ €} * 3.99 \% = 372,074 \text{ €}$$



3.4 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)

Siç u përmend më parë, llogaritja/përcaktimi i Kthimit të lejuar llogaritet bazuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara RAB_f dhe Normën e kthimit (RoR), pra përfshin dy komponentët në vijim:

- Përcaktimin (vendosjen) e Bazës së Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuar (RAB_f); dhe
- Llogaritjen e Normës së Kthimit të lejuar (RoR), të përcaktuar në vlerën e WACC-ut.

Komponenta e parë - RAB_f është llogaritur në kapitullin 3.2 – tabela '6', ndërsa llogaritja e komponentës së dytë – RoR përcaktohet në kapitullin vijues:

3.4.1 Llogaritja e Normës së Kthimit (RoR) të Lejuar

Objekti i Normës së kthimit të arsyeshme (RoR) në Bazën e rregulluar të asetëve (RAB), është që të garantoj ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për një fitim që lejon të vazhdohet me investimet në asete, në mënyrë që të mund ti rehabilitoj dhe ti zgjeroj ato.

Një RoR i arsyeshëm konsiderohet të jetë norma e "Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit" (WACC), që llogaritet në komponentët e bazës së kapitalit, duke marrë parasysh ponderimet e shumave të këtyre komponentëve të kapitalit. Me fjalë tjera, WACC-u është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit.

Për koston e ekuitetit, ZRRE-ja ndjek metodologjinë e njohur ndërkombëtare të quajtur "Modeli i Çmimit të Kapitalit të Aseteve" (CAPM). CAPM shpreh koston e pritur të ekuitetit si një normë pa rrezik (r_f) plus premiumin e rrezikut të ekuitetit (ERP). Ne mund ta definojmë ERP si ndryshimin mes rrezikut të tregut të ekuitetit – d.m.th. kthimi i pritur nga tregu i zhvilluar mirë – dhe normën e kthimit pa rrezik, e që shprehet me formulën e paraqitur më poshtë:

$$ERP = (r_m - r_f)$$

Norma e ERP varet nga rreziku i investimit në një treg të një vendi të veçantë.

Vlera e WACC-ut para tatimeve mund të llogaritet sipas formulës në vijim:

$$WACC_{pre-tax} = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

ku:

D/V	Raporti i borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
E/V	Raporti i ekuitetit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
V	Totali i bazës së kapitalit, që është shuma e ekuitetit dhe borxhit
k_d	Kostoja e Borxhit
k_e	Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e borxhit (k_d) është zotim kontraktual dhe është norma interesit që ndërmarrja paguan në huatë (kreditë) aktuale.

Kostoja e ekuitetit (k_e) llogaritet si në vijim:



$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:

r_f	Norma pa rrezik dhe nxirret nga vlerësimet për kthimin në obligacionet ("bondet") e qeverisë
β_e	"Beta": masa e rrezikut për kompaninë përkatëse
$(r_m - r_f)$	Premiumi i rrezikut të tregut të ekuitetit minus norma e kthimit pa rrezik

"Premiumi i rrezikut" është përcaktuar nga "beta" dhe nga premiumi i rrezikut të pritur të një tregu, e që investitorët e kërkojnë nga tregu si tërësi. Faktori "beta" matë pa-parashikueshmërinë e kthimit të një kompanie në relacion me tregun e mallrave (aksioneve) si tërësi.

Më poshtë ne vlerësojmë / llogarisim koston e borxhit dhe koston e ekuitetit për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë, për të ardhur tek WACC para tatimeve.

Kostoja e Borxhit

Për këtë sezon të ngrohjes dhe sezonet vijuese, ZRRE-ja ka vendosur që raporti D/V në vlerën 60/100 (60% borxh dhe 40% ekuitet). Ky raport 60% duhet të përdoret në vlerësimet / llogaritjet e WACC-ut komercial para tatimeve për sezonin e ngrohjes 2022/2023, si dhe për sezonet vijuese, nëse nuk vërehen ndryshime domethënëse.

Kostoja e borxhit (k_d) paraqitet si funksion i normës pa rrezik që zakonisht reflekton normat aktuale dhe projeksionet e obligacioneve qeveritare dhe premiumit të riskut të borxhit që merr parasysh normat mesatare të kredive investive.

$$k_d = 8.79 \%$$

Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e ekuitetit paraqitet me formulën më poshtë:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:

$$(r_m - r_f) = \text{ERP} - \text{Premiumi i Rrezikut në Ekuitet}$$

Norma pa Rrezik ("Risk Free Rate - r_f) aktualisht, bazuar në trendet financiare vendore dhe ndërkombëtare të obligacioneve qeveritare (bonove të thesarit) vlerësohet në rangun prej 1.1 deri 3.0%. Kufiri i ulët përfaqëson nivelin e interesave për bonot e thesarit afatgjatë të Kosovës përderisa kufiri i lartë përfaqëson mesataren 10 vjeçare interesave nga bonot e thesarit të Hungarisë – që përfaqëson emetuesin më të rrezikshëm të borxhit të tregtuar afatgjatë në mesin e krahasuesve rajonal. Bazuar në këtë ZRRE e fikson Normën pa Rrezik në vlerën 2.3 %.

Vendimet e fundit të autoriteteve rregullative e vlerësojnë premiumin e rrezikut në ekuitet në rangun prej 3.5 gjer në 5%. Për shkak se NQ Gjakova është ndërmarrje publike konsiderohet se rreziku në ekuitet është minimal dhe rrjedhimisht përvetësohet që vlera e ERP-së të jetë e barabartë me 4.5%.



Beta mesatare e asetëve për rrjetet e energjisë elektrike në BE dhe për ndërmarrjet e integruara është 0.42 e krahasuar me 0.54 - 0.63 për ndërmarrjet që kanë vetëm gjenerimin dhe furnizimin në BE dhe SHBA. Për shkak se industria e ngrohjes qendrore në Kosovë është e vogël, duket e arsyeshme që të supozojmë se rritja e kërkesës – që është faktori kryesor për rritjen e të ardhurave – do të jetë më e pa-parashikueshme se sa rritja e GDP – që është faktori kryesor për rritjen e tregut të mallrave dhe aksioneve – se sa në vendet e mëdha dhe të zhvilluara. Shtimi i një konsumatori të vetëm të madh në ngrohjen qendrore do të thotë rritjen e kërkesës për ngrohje qendrore në krahasim me kërkesën e mëparshme, përderisa ndikim në GDP mund të jetë shumë më i vogël. Në mënyrë që ta marrin në konsideratë natyrën më të pa-parashikueshme të të ardhurave të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në krahasim me rritjen e GDP, ne vlerësojmë që kostoja e ekuitetit të jetë më e lartë se sa mesatarja e vendosur nga rregullatorët e BE-së, dhe ne konsiderojmë se “ β_e ” e arsyeshme për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë të jetë $\beta_e = 1$.

Kostoja e ekuitetit pas tatimeve është si në vijim:

$$k_{e \text{ post tax}} = 2.3\% + (1 * 4.5\%) = 6.80\%$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve gjendet duke shumëzuar rezultatin më lartë të kostonë së ekuitetit pas tatimeve me relacionin që e konsideron tatimin (“tax wedge”) si më poshtë:

$$\text{‘Tax wedge’} = 1/(1-t)$$

ku:

t Shkalla e tatimit në fitimin e kompanive

Tatimi në fitim (t) në Kosovë është 10% dhe relacioni që e konsideron tatimin (“tax wedge”) është:

$$1/(1-0.10) = 1.11$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve është:

$$k_{e \text{ pre-tax}} = 6.80\% * 1.11 = 7.55\%$$

Si rrjedhim i llogarive më lartë llogaritet WACC-u para tatimeve – i rumbullakuar në dy decimale – si më poshtë:

$$WACC_{\text{pre-tax}} = [8.79\% * 0.6] + [7.55\% * 0.4] = 8.30\%$$

Llogaritja e Kthimit të Lejuar në RAB_f për NQ Gjakova

Bazuar në WACC_{pre-tax} e llogaritur prej 8.30% në 3.4.1, llogaritet Kthimi i lejuar apo Profiti i lejuar për NQ Gjakova, sipas formulës më poshtë:

$$RET = RoR \times RAB_f$$

Pra Kthimi i lejuar në RAB_f është i barabartë me $32,337\text{€} * 8.30\% = 2,683 \text{€}$.



Tabela 9: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB_f për sezonin e ngrohjes 2022/2023

Kthimi i Lejuar në RAB _f për NQ GJAKOVA		Lejuar nga ZRRE [€]
RAB _f	Baza e Rregulluar e Aseteve - vetëfinancuar	32,337
RoR	Norma e Kthimit në vlerën e WACC	8.30%
	Kthimi i Lejuar në RAB _f	2,683

3.5 Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet

Kostoja e lejuar e humbjeve të rrjetit shërben për të mbuluar kostot që i shkaktohen ndërmarrjes për shkak të humbjeve të energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes. Në përputhje me Shtojcën 1 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike kjo kosto llogaritet si herësi në mes të humbjeve sasiore të rrjetit dhe prodhimit të energjisë termike që hyn në rrjet (niveli në përqindje i humbjeve të tërësishme në rrjet), kjo e shumëzuar me koston e përgjithshme variable të prodhimit.

Nga sa u tha më lartë, bazuar në dhënat e paraqitura nga NQ Gjakova dhe në vlerësimet e veta, ZRRE ka zhvilluar Bilancin e energjisë termike të NQ Gjakova për sezonin 2022/2023, përmes së cilit ka përcaktuar humbjet sasiore të rrjetit **2,935 MWh**. Shprehur në përqindje, niveli i përgjithshëm i humbjeve në rrjet është 20%. Gjithashtu nga Bilanci i energjisë termike është derivuar sasia e prodhimit (gjenerimit) neto të energjisë termike prej 14,674 MWh.

Bazuar në vlerat më lartë dhe në koston variable operative (1,015,091 €) llogaritet **Kostoja e humbjeve në rrjet në vlerën 203,018 €**.

3.6 Përshtatja (Akhustimi)

Përshtatja (axhustimi) shërben për të korigjuar ndryshimet eventuale mes planifikimeve të shqyrtimit tarifor për periudhën (sezonin) 'n-1' dhe realizimeve që faktikisht kanë ndodhur në atë periudhë (sezon) dhe ato ndryshime përfshihen (korigjohen) në shqyrtimin e ardhshëm.

Duke qenë se në këtë sezon zhvillohet procesi i shqyrtimit tarifor pas një periudhe disa vjeçare, pra shqyrtimi tarifor në këtë sezon konsiderohet si shqyrtimi bazë, atëherë për këtë shqyrtim nuk do të aplikohet përshtatja (axhustimi). Normalisht për shqyrtimet e ardhshme përshtatja do të përcaktohet dhe do të jetë komponentë përbërëse e të Hyrave të lejuara.

3.7 Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara - Përmbledhje

Të hyrat e lejuara totale janë llogaritur sipas formulës:

$$\text{MAR} = \text{OC} + \text{DEP} + \text{RTN} + \text{LOS} +/\text{- ADJ}$$

Fillimisht duhet theksuar se në llogaritjen e të Hyrave maksimale të lejuara merren Kostot operative të zbritura për koston e lejuar të humbjeve dhe gjithashtu nëse ka subvencione për kostot operative atëherë zbritet edhe vlera e subvencionit (të ashtuquajtura neto kostot operative të lejuara në vlerë prej **261,980 €**)



Rrjedhimisht duke përdorur formulën më lartë, vlera e MAR është e barabartë me **839,754 €** siç paraqitet detajisht në tabelën 6.

Tabela 10: Të Hyrat e lejuara për NQ Gjakova sezoni i ngrohjes 2022/2023

Të Hyrat e Lejuara NQ GJAKOVA për sezonin 2022/2023		Lejuar nga ZRRE [€]
OC	Kostot Operacionale të Lejuara (neto)	261,980
DEP	Zhvlerësimi Vjetor	372,074
RTN	Kthimi i Lejuar në RAB _r	2,683
LOS	Kostot e lejuara të humbjeve	203,018
ADJ	Axhustimi – ndryshimi mes lejjimeve dhe realizimeve	N/A
MAR	Të Hyrat Maksimale të Lejuara	839,755

Për të qenë në përputhshmëri me strukturën tarifore, që parasheh ndarjen në komponentën për kapacitetin termik (komponenti fiks) dhe në komponentën e sasisë së energjisë termike, ndarja e MAR-it në pjesën fikse dhe variable për sezonin e ngrohjes 2022/2023 është si vijon:

Pjesa fikse e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR_f) **83,976 €; dhe**
Pjesa variable e të Hyrave të Lejuara (MAR_v) **755,779 €.**

4 Bilanci i Energjisë Termike

Bilanci i energjisë termike është një komponentë mjaft e rëndësishme në shqyrtimin tarifor sepse përcaktohen projeksionet për prodhimin/blerjet e energjisë termike, humbjet në rrjet dhe përfundimisht furnizimin e konsumatorëve. Për këtë arsye projeksionet në Bilanc janë me ndikim në planifikimin e kostove respektive, dhe rrjedhimisht me ndikim në përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe tarifave.

Në vijim në forma tabelare dhe grafike janë paraqitur të përmbledhur komponentët e Bilancit të energjisë termike për NQ Gjakova për shqyrtimin tarifor të sezonit 2022/2023.

Tabela 11: Përmbledhje e Bilancit të energjisë termike

Bilanci i Energjisë Termike - NQ Gjakova sez. 2022/2023		
Bruto Prodhimi i En. Term. në 2 njësitë HoB	MWh	7,890
Bruto Prodhimi i En. Term. në CHP	MWh	6,844
Total Bruto Prodhimi i En. Term.	MWh	14,734
Konsumi vetanak	MWh	60
Neto Prodhimi i En. Term. (Hyrja në Rrj. E Shpërndarjes)	MWh	14,674
Humbjet sasiore në Rrjetin e Shpërndarjes	MWh	2,935
Humbjet në përqindje në Rrjetin e Shpërndarjes	%	20.00%
Furnizimi / Konsumi i En. Term.	MWh	11,739